



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.604/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizjes VETËVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Sallën e Sporteve "1 Tetori" në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa Anr.604/2025, e datës 22.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizjes VETËVENDOSJE!, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Sallën e Sporteve "1 Tetori" në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 22.02.2025, PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje, në të cilën theksohet se më 21 shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Prishtinë, gjatë procesit të numërimit të votave në Sallën e Sporteve "1 Tetori" në Prishtinë, ka vërejtur se dy fletëvotime nga Vendvotimi më numër 1935/05, janë shpallur të pavlefshme nga komisionerët përkatës, ndonëse fletëvotimet kanë qenë në përputhje me nenin 16 të Rregullores zgjedhore nr. 12/ 2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit.

E gjithë kjo për faktin se në fletëvotime është vendosur shenja Tik për subjektin politik LVV, dhe jashtë katrorit vërehet, të numrat e kandidatëve gjithashtu janë vendosur tiks, mirëpo në asnjë moment nuk janë vendosur në ndonjërin prej katrorëve (shenjave) të ndonjë subjekti tjetër politik.

Pra, në të dyja fletëvotimet, vërehet qartë qëllimi i votuesit se për cilin subjekt ka votuar, dhe të cilat janë në përputhje të plotë me nenin 16 të Rregullores zgjedhore Nr.12/2024 votimi, numërimi në vendvotim dhe menaxhimi i vendvotimit. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë Fletëvotimet.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja, theksohet se bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike.

Në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse: Janë shënuar më shumë se një subjekt politik; Nuk është shënuar asnjë subjekt politik; Janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik; Qëllimi i votuesit nuk është i qartë.

Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit. Gjithashtu, njoftojmë PZAP, se me datën 21.02.2025, në ora 20:15 është përmbyllur procesi i numërimit të votave të kandidatëve për deputetë dhe verifikimit të votave të subjekteve politike nga formularët e plotësuar në vendvotime më 9 shkurt 2025, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në komunën e Prishtinës dhe i gjithë materiali zgjedhor duk përfshirë edhe kamerat e sigurisë, të përdorura për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 09 shkurt 2025, janë dorëzuar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) e komunës së Prishtinës më datën 22.02.2025, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar

Paneli vlerësoi se janë të pabazuara pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendon se në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), gjatë procesit të numërimit të votave në Sallën e Sporteve "1 Tetori" në Prishtinë, ka vërejtur se dy fletëvotime nga Vendvotimi më numër 1935/05, janë shpallur të pavlefshme nga komisionerët përkatës. Nga fotot e bashkangjitura si provë në ankesë shihet se në fletëvotime, Tiku është i vendosur në katrorin pranë numrit 118 Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa tikat jashtë katrorit të numrat e kandidatëve janë vendosur në hapësirën ku gjenden të radhitur subjektet politike, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë, ndaj nga shikimi i këtyre fotove shihet se këto fletëvotime janë të pavlefshme pasi që nuk mund të konsiderohet se është votuar vetëm subjekti politik LVV për të cilën pretendon pala me ankesë. Neni 16 paragrafi 2 Rregullore Zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës përcakton se *“vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit”* Ndërsa vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: *Kur votohet më shumë se një subjekt politik;*

kur nuk votohet asnjë subjekt politik; kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.

Prandaj duke u mbështetur në nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, i cili përcakton se "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e tij pasi që nga provat e ofruara si dëshmi shihet qartë se fletëvotimet në fjalë nuk janë plotësuar sipas rregullave të votimit si dhe sipas dispozitave të sipërcituara dhe mbi këtë bazë këto fletëvotime duhet të shpallen të pavlefshme.

Paneli gjatë vendosjes së ankesës i ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes të gjitha provat dhe ka vërtetuar në mënyrë të plotë se pretendimet ankimore janë të pa bazuara në ligj, andaj ankesa u refuzua e pa bazuar në kuptim të nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, dhe mbi këtë arsye paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 4, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 paragrafi 10 nën paragrafi 10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.604/2025, datë 24.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.